



Pranuar / Dorezuar Priljevoj/Prodato Received/Delivery	21.03	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtup / Prilog Appendix	Sasia Kolicima Quantity	
SKPMSHK	1473/2022		114	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.92/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca -anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.92/2022 të datës 03.02.2022 të parashtruar nga ankuesi

Komuna e Gjakovës, kundër vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021, respektivisht kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve të punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 21.03.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. ANULOHET vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 i datës 31.01.2022 për ankuesin
- II. OBLIGOHET Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i ankuesit respektivisht Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Operacione pranë Administratës Tatimore të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë *rivlerësimin e rezultateve në punë* për ankuesin në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- III. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, që të ndër marr veprimet që zbatimi i këtij vendimi të bëhet në sipikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës sipas akt emërimit me numër të protokollit 02/679/09 të datës 05.05.20217 është në pozitën "Drejtor", në Drejtorinë e Drejtorisë Rajonale, dhe është vlerësuar nga Zv. Drejtori i Përgjithshëm për Operacioni i Administratës Tatimore të Kosovës për periudhën janar-dhjetor të vitit 2021, me notën e përgjithshme 3.2.

Ankuesi, kundër vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021, me datën 03.02.2022 ka parashtruar ankesë nëpërmjet e-mail-it zyrtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 510/2022, me pretendim ankimor kundër vlerësimit të rezultatit të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitive ligjore në fuqi me datën 08.02.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Administratën Tatimore të Kosovës. Me datën 16.02.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Vendimi me numër 05/2022 i datës 04.03.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankuesit e datës 03.02.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari i vlerësimit i rezultateve të punës për vitin 2021; Shpërndarja normale e notimit e performancës, përforcimi i rangimit të punëtorëve; Akt emërimi i ankuesit i datës 05.05.2017; Formulari për përshkrimin e detyrave të punës; e-mail-at e datave 16.12.2021; 07.06.2021; 03.06.2021; 12.01.2021; 30.12.2021; 23.12.2021; 22.12.2021; 14.12.2021; 13.12.2021; 03.12.2021; 25.11.2021; 22.11.2021; 20.12.2021; 18.11.2021; 11.12.2021; 05.11.2021; 11.10.2021; 01.11.2021; 17.11.2021; 16.09.2021; 10.08.2021; 09.08.2021; 16.09.2021; 31.08.2021; 18.08.2021; 10.08.2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankuesit të kthehet në *ri-vlerësim, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 03.02.2022 ka theksuar që formularin e vlerësimit për periudhën janar-dhjetor të vitit 2021, e ka pranuar me datën 31.01.2022, ndërsa ankuesi me datë 01.02.2022 e ka nënshkruar formularin e vlerësimit të punës duke i dhënë edhe komentet lidhur me vlerësim të punës lidhur me realizmin e planit profesional të objektivave dhe aktiviteteve të punës po ashtu ankuesi e ka kontestuar se vlerësimi i punës është bërë nga personi jo kompetente pasi që edhe sipas Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.461/2021 të datës 23.06.2021 dhe të Vendimit me numër 186 të datës 09.07.2021 Zv.





Drejtori i Përgjithshëm i Operacioneve është z  
të punës për ankuesin është bërë nga

ndërsa vlerësimi i rezultatit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar pasi që vlerësimi i punës për ankuesin për vitin 2021 është bërë nga personi jo kompetent rrjedhimisht gjendja faktike dhe ligjore është vërtetuar edhe me Vendimin me numër 05/2022 të datës 04.03.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me të cilin është miratuar Raporti i Monitorimit të Jashtëzakonshëm në Administratën Tatimore të Kosovës, andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 43 paragrafit 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik që ka përcaktuar se: *"Nëpunësi civil vlerësohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse"*, si dhe paragrafin 6 i po këtij neni ka përcaktuar se: *"Gjatë periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takime me nëpunësin që vlerësohet, për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuar për të shprehur mendime dhe për të dhënë sugjerime, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim"*.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit lidhur për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 pa pasur asnjë takim paraprak nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë analizimit dhe shqyrtimit të provave të lëndës konkretisht, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i qëndrueshëm sepse nuk ka asnjë dëshmi që udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit në fund të periudhës së vlerësimit ka ftuar ankuesin për të diskutuar për realizimin e objektivave dhe rezultateve të arritura, ashtu siç parashihet me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, i cili përcakton se: *"Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave dhe i aftësive profesional të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: takimi për diskutimin e realizimit të objektivave dhe rezultateve të arritura; vlerësimin (notimi) e objektivave"*, po ashtu në provat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi që mbikëqyrësi është takuar me ankuesin gjatë periudhës vlerësuese për të rishikuar progresin e bërë siç parashihet me nenin 7 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave obligon Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, si udhëheqësin më të lartë administrativ që të ndërmarrë te gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi, ndërsa Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit në pajtim me të gjeturat e këtij vendimi të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021 për periudhën janar-dhjetor 2021 për ankuesin si dhe të gjitha procedurat dhe afatet që kanë të bëjnë me procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës t'i zhvilloj në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.92/2022**

Valentina Kaçandolli Bekteshi



Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit*
- *Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;*
- *Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*

